

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN BRADASHESH

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën Bradashesh, Elbasan**, me objekt: “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën e veprimtarisë 01.07.2012 deri më 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 23, datë 30.06.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1149/7, datë 13.03.2015, i ka rekomanduar z. Sabri Sallaku, Kryetar i komunës Bradashesh Elbasan, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Komuna Bradashesh nuk ka zbatuar rekomandimin e lënë nga auditimi i mëparshëm, për ndjekjen në rrugë ligjore dhe likuidimin e vlerës 223,549 lekë përkatësisht: nga Dh.Duli 151,688 lekë, Th.D 35,004 lekë dhe L.T 36,857 lekë, paguar më tepër nga tarifa për kolaudim të objekteve, në kundërshtim me pikën “b” “Tarifat për Kolaudimin përfundimtar të Ndërtim Montimit”, të VKM 444, datë 05.09.1994 “Për tarifat e Studimit, Drejtimit dhe Kolaudimit të Ndërtimit”.

1.1. Rekomandim: Komuna Bradashesh të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe shkallët e gjykimit, shpërblimin e dëmit në vlerën **223,549 lekë**, përkatësisht: nga Dh.D 151,688 lekë, Th.D 35,004 lekë dhe L.T 36,857 lekë, paguar më tepër nga tarifa për kolaudim të objekteve.

Brenda datës 30.5.2015

2. Gjetje nga auditimi: Komuna Bradashesh për vitin 2012 nuk ka plotësuar detyrimin e përgatitjes dhe nënshkrimit të deklaratës dhe raportit vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë, për vitin e mëparshëm buxhetor, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

2.1. Rekomandim: Komuna Bradashesh të marrë masa dhe të plotësojë, detyrimin e përgatitjes e nënshkrimit të deklaratës dhe raportit vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë, për vitin e mëparshëm dhe për çdo vit buxhetor.

Vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi: Komuna Bradashesh nuk ka përgatitur regjistrin e raportimeve dhe masave të marra për parandalimin e mashtrimit e parregullsive dhe vendosjen e Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm. Gjithashtu nuk është miratuar dhe vënë në funksionim sistemi informacionit dhe komunikimit, si dhe nga nëpunësi autorizues nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për minimizimin e riskut, mashtrimit e parregullsive dhe parandalimin e tyre, në kundërshtim me nenin 21, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”..

3.1 Rekomandim: a. Grupi i menaxhimit strategjik (GMS) të njësisë publike të marrë masa për hapjen, mbajtjen, plotësimin e regjistrit të raportimeve dhe masave të marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive, për vendosjen e sistemit të informacionit dhe komunikimit si dhe Sistemin e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm.

b.GMS të marrë masa për minimizimin e riskut të mashtrimit dhe parregullsive, dhe nga nëpunësi autorizues të regjistrohen dhe raportohen masat e marra për parandalimin e tyre, si dhe të miratohet dhe vihet në funksionim sistemi informacionit dhe komunikimit.

Vazhdimisht

4. Gjetje nga auditimi: Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit nuk ka plotësuar dokumentacioni teknik dhe ligjor të dosjes së vendimit nr. 7, dt. 21.11.2014, për miratimin e kërkesës së z. P.B, për leje zhvillimore të objektit “Ndërtim Struktura 2 kate Rrobaqepësi (Fasoneri) fshati Katundi Ri”, pasi mungojnë: Genplani i hartuar nga sektori i

GIS, leja e miratuar nga Agjencia Rajonale e Mjedisit për lidhjen e strukturës me pikën më të afërt të depozitimit të mbetjeve, mungon studimi sizmologo-inxhinierik dhe fotokopja e noteruar e licencës individuale e inxhinierit gjeolog, në kundërshtim me VKM nr 459, datë 16.06.2010.

4.1. Rekomandim: Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të marrë masa dhe të plotësojë dosjen e vendimit nr. 7, datë 21.11.2014 për lejen zhvillimore të objektit “Ndërtim Struktura 2 kate Rrobaqepësi (Fasoneri) fshati Katundi Ri”, me dokumentacionin përkatës, Genplani i hartuar nga sektori i GIS, leja e miratuar nga Agjencia Rajonale e Mjedisit për lidhjen e strukturës me pikën më të afërt të depozitimit të mbetjeve, mungon studimi sizmologo-inxhinierik dhe fotokopja e noteruar e licencës individuale e inxhinierit gjeolog.

Brenda datës 30.5.2015

5. Gjetje nga auditimi: Komuna Bradashesh nuk ka përfunduar procesin e regjistrimit në ZVRPP Elbasan, të pronave të transferuara me VKM nr. 81, datë 30.1.2013 “*Për Miratimin e listës përfundimtare të pronave të pa luajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim*”, sipas listës së objekteve me 260 fletë me 1915 pasuri, bashkëlidhur VKM , në kundërshtim me kreun IV, nenet 13 e 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “*Për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Publike të Shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore*”.

5.1 Rekomandim: Komuna Bradashesh të marrë masat dhe të regjistrojë në ZVRPP asetet dhe pasuritë e tjera, sipas listës së miratuar për 1915 pasuri.

Brenda datës 30.5.2015

6. Gjetje nga auditimi: Komuna Bradashesh nuk ka ngritur dhe vënë në funksion strukturat dhe Zyrën për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës (ZAMT), mosveprim në kundërshtim me nenin 6, kreu II, neni 10, kreu III, neni 11 dhe nenin 13, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “*Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës*”.

6.1 Rekomandim: Kryetari i komunës Bradashesh të marrë masat e nevojshme, për përshtatjen e Strukturës dhe organigramës së Njësisë duke përfshirë Zyrën e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZAMT) me personelin përkatës si dhe të vihet në funksionim dhe me efikasitet të plotë në përmbushje të funksioneve ligjore të saj.

Brenda datës 30.4.2015

7. Gjetje nga auditimi: Komuna Bradashesh nuk ka kryer inventarizimin fizik dhe nuk ka përfshirë në pasqyrën përkatëse të evidencës kontabël vlerën e zërit “Toka, troje, terrene etj”, pasi në asnjë bilanc të periudhës objekt auditimi, kjo vlerë jo vetëm që nuk pasqyrohet në rreshtin 10 të llogarisë 210, dhe gjithashtu nuk ka përgatitur pasqyruar as bilancin e fondit të tokës sipas strukturës ligjore përkatëse, në kundërshtim me pikat 1,2, të nenit 7, Kreu II, neni 12, Kreu III, pika 1, neni 18, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”, i ndryshuar.

7.1 Rekomandim: Komuna Bradashesh të marrë masa për kryerjen e inventarizimit fizik dhe të përfshijë vlerën në pasqyrën përkatëse të evidencës kontabël rreshti 10 llogaria 210 të zërit: “Toka, troje, terrene, objekte, etj”, si dhe të hartojë e pasqyrojë zërat në bilancin e fondit të tokës.

Brenda datës 30.5.2015

8. Gjetje nga auditimi: Në Komunën Bradashesh Përgjegjësi dhe Inspektori i Policisë së Komunës, janë me arsim të mesëm të përgjithshëm dhe nuk kanë kaluar në testim nga policia e shtetit, mosveprim në kundërshtim me urdhrin e përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 7.4.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “*Për Miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të komunës*”.

8.1 Rekomandim: Komuna Bradashesh të marrë masa për rregullimin e strukturës së Policisë së Komunës duke zbatuar procedurat e përzgjedhjes dhe kriteret ligjore në marrjen në punë të punonjësve të Policisë së Komunës.

Menjëherë dhe vazhdimisht

9. Gjetje nga auditimi: Struktura e Policisë së Komunës Bradashesh nuk ka hartuar e miratuar tek titullari për periudhën e audituar programe vjetore, mujore dhe ditore pune, si dhe nuk ka pasqyruar në librat përkatës plan vendosjen në detyrë të efektivit të Policisë dhe gjithashtu, punonjësit e policisë nuk i janë nënshtruar trajnimeve lidhur me testet teorike dhe fizike.

9.1 Rekomandim: Struktura e Policisë së Komunës Bradashesh të marrë masa për të hartuar e miratuar tek titullari programe vjetore, mujore dhe ditore pune, si dhe të çelë e pasqyrojë në librat përkatës plan vendosjen në detyrë të efektivit të Policisë aktivitetin e saj dhe gjithashtu, të programojë e zbatojë trajnimeve duke kryer testet teorike dhe fizike.

Menjëherë dhe vazhdimisht

10. Gjetje nga auditimi: Komuna Bradashesh nuk ka hartuar plane-veprimi për periudha afatmesme 3 vjeçare dhe vjetore të lidhjes dhe bashkëveprimit të drejtpërdrejtë ndërmjet prioritetëve strategjike, për krijimin dhe shpërndarjen e burimeve, kryerjen e shpenzimeve, si dhe marrjen në konsideratë dhe vënien në efikasitet të aseteve.

10.1 Rekomandim: Komuna Bradashesh të hartojë plane-veprimi për periudha afatmesme dhe vjetore me qëllim sigurimin e lidhjes dhe bashkëveprimit të drejtpërdrejtë ndërmjet prioritetëve strategjike, në krijimin dhe shpërndarjen e burimeve, pra kryerjen e shpenzimeve, si dhe të marrë në konsideratë vënien në efikasitet të aseteve.

Menjëherë dhe vazhdimisht

11. Gjetje nga auditimi: Komuna Bradashesh ka bërë asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit, pa bërë më parë vlerësimin e tyre, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rekomandim: Komuna Bradashesh për çdo rast të kryejë vlerësimin për vlerën e përdorimit të aktiveve, para se të bëjë asgjësimin për nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit.

Vazhdimisht

12. Gjetje nga auditimi: Komuna Bradashesh zyra e financës nuk ka kryer veprimet e kontabilizimit dhe nuk ka pasqyruar në bilanc detyrimet e pa arkëtuara prej vitesh të rrjedhura nga taksat dhe tarifat vendore, duke krijuar mungesë të ardhurash në buxhetin e komunës në vlerën 36,892,864 lekë; ndarë: për llogari të biznesit të madh detyrime të mbartura nga 23 subjekte në shumën 31,744,927 lekë dhe për biznesin e vogël për 49 subjekte në shumën 4,982,431 lekë, ndërsa tarifat e pa shlyera nga të punësuarit në komunë, për 16 persona në shumën 165,506 lekë.

12.1. Rekomandim: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Zyrën e Financës, të marrin masa për kryerjen e veprimeve të kontabilizimit dhe ndjekjen e procedurave ligjore lidhur me arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera deri më 31.12.2014 në vlerën **36,892,864 lekë**, përkatësisht: për taksën e biznesit të madh nga 23 subjekte në vlerën **31.744.927 lekë**, për taksën e biznesit të vogël nga 49 subjekte në vlerën **4,982,431 lekë**, për të punësuarit në komunë për 16 persona në vlerën **165,506 lekë**.

Brenda datës 30.5.2015

13. Gjetje nga auditimi: Komuna Bradashesh gjatë programimit të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, nuk ka programuar e përfshirë të ardhura nga detyrimet e prapambetura për vitet ushtrimore 2012, 2013 e 2014, por ato janë programuar vetëm për pjesën e vitit ushtrimor, ndërsa shlyerja e detyrimeve të prapambetura, në mënyrë të parregullt është përfshirë si realizim të ardhurash për vitin ushtrimor përkatës.

13.1. Rekomandim: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore të marrë masa, që të diferencohen detyrimet e shlyera për llogari të viteve të mëparshme dhe të analizohen si zë i veçantë, ndërsa detyrimet e prapambetura në programimin e të ardhurave të vitit 2015, të evidentohen si zë i veçantë “Të ardhura për tu realizuar”, duke i pasqyruar në llogarinë nr. 4341 “Të tjera operacione me shtetin (kreditorë)”.

Menjëherë dhe vazhdimisht

14. Gjetje nga auditimi: Komuna Bradashesh nuk ka bashkërenduar me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe për zgjidhjen e problemit të shmangies nga përfitimi dhe trajtimi me ndihmë ekonomike për 20 familje të komunitetit Egjiptian të cilët nuk kanë

asnjë të ardhur e as disponojnë tokë , gjendje kjo e verifikuar dhe konstatuar nga inspektorëte Komunës dhe për shkak të mosfunksionimit të sistemit të pikëzimit pas muajit Qershor 2014 me sistemin e ri të pikëzimit, janë përjashtuar nga përfitimi i merituar, gjendje kjo në kundërshtim me VKM nr.904, datë 12.12.2012”Për përcaktimin e kritereve të përfituesve dhe të masës së ndihmës ekonomike”.

14.1. Rekomandim: Komuna Bradashesh të marrë masa dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të plotësohet dokumentacioni i domosdoshëm për trajtimin me ndihmë sociale të 20 familjeve të komunitetit Egjiptian, aktualisht me të ardhura poshtë nivelit të jetesës, të cilave ju është ndërprerë ndihma ekonomike nga muaji Qershor 2014.

Brenda datës 30.03.2015

15. Gjetje nga auditimi: Komisioni i vlerësimit të ofertave ka funksionuar vetëm me me specialist të profesionit ekonomist , duke mos patur në përbërje specialistë të fushave të tjera përkatëse inxhinier e jurist, gjendje kjo në kundërshtim me gërmat “c” dhe “ ç”, pika 1, kreu V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

15.1. Rekomandim: Komuna Bradashesh të marrë masa që në përbërjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, të caktohen specialistë të fushave përkatëse duke përfshirë inxhinier e juristë, për të bërë të mundur vlerësim ligjor e korrekt të ofertave në zbatim të procedurave të prokurimit publik.

Brenda datës 30.03.2015

16. Gjetje nga auditimi:Komuna Bradashesh në hartimin e kontratave të ndërtimit lidhur me Garancitë e punimeve të ndërtimit ka vendosur afate minimale deri një vit, dhe në kontratën e objektit “Ndërtimi i Shkollës Mesme Katund i ri” me **vlerë 164,370,151 lekë** me TVSH, afati është minimal 1 vit duke shmangur afatin 2 vjet , në kundërshtim me udhëzimin nr.1, datë 22.02.2005 ”Për Disa Shtesa në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001”, ky afat duhet të jetë deri në dy vjet.

16.1. Rekomandim: Komuna Bradashesh të marrë masa dhe të vendosë afate maksimale për garancinë e punimeve në kontratat e ndërtimit të objekteve, kryesisht për objektet me natyrë të veçantë dhe me vlera të mëdha.

Menjëherë dhe vazhdimisht

17. Gjetje nga auditimi: Komuna Bradashesh, autoriteti kontraktor në përfundim të kontratave për mallra e shërbime nuk ka përgatitur raportin përmbledhës lidhur me korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratave, në kundërshtim me përcaktimet në pikën 2/b, kreu VIII, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 ”Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

17.1. Rekomandim: Komuna Bradashesh të marrë masa që për çdo kontratë të lidhur për mallra e shërbime, pas përfundimit të të saj të përgatisë raportin përmbledhës, ku të pasqyrohet korrektësia dhe cilësia e zbatimit të kontratës dhe një kopje e këtij raporti ti jepet kontraktorit.

Në vazhdimësi

18. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me procedurë të hapur, me objekt “Ndërtimi i shkollës Mesme Katundi i Ri”, me fitues bashkimi i operatorëve “Ergi” sh.p.k. & “Bajrami N” sh.p.k., rezulton se operatori ekonomik “Bajrami N”sh.p.k. **ka patur një detyrim të pashlyer ndaj komunës Bradashesh në vlerën 482,000 lekë**, për mosrespektim të kushteve të kontratës nr. 163, datë 21.03.2011, por Komuna Bradashesh ka pranuar në procedurë duke mos marrë në konsideratë detyrimin e pashlyer nga operatori ekonomik “Bajrami N”, dhe nuk ka vepruar kundërt tij për kërkimin e shlyerjes së detyrimit financiar.

18.1. Rekomandim: Komuna Bradashesh të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore në prokurime dhe procedurat për arkëtimin e detyrimit **në vlerën 482,000 lekë ndaj** operatori ekonomik “Bajrami N”sh.p.k.

Brenda datës 30.04.2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në nenet 105-109, kreu I, pjesa e VI, të ligjit nr. 8485, datë 08.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë

20.12.2011 “ *Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”, kapitulli IV (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe të ndiqen rrugët ligjore, për kërkimin e shpërblimit të dëmit në vlerën **2,841,730 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Komuna Bradashesh me urdhër shpenzimi nr. 252, datë 12 tetor 2012(sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit) ka kryer pagesa për karta telefoni për vitin 2012, për 11 persona të administratës në vlerën **370,000 lekë**, në kundërshtim me pikën 9,14 dhe 15 të VKM nr. 864 datë 23.07.2010 “Për Pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik publik”.

1.1. Rekomandim: Komuna Bradashesh të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit deri ato përmbarimorë, për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **370,000 lekë**, ndaj personave përcaktuar në tabelën nr. 1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.05.2015

2. Gjetje nga auditimi: Komuna Bradashesh me Urdhër shpenzimi nr. 81, datë 5.4.2013(sipas tabelës nr. 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit), ka kryer pagesa për karta telefoni për vitin 2013, për 11 persona të administratës në vlerë **370,000 lekë**, në kundërshtim me pikën 9,14 dhe 15 të VKM nr. 864 datë 23.07.2010 “Për Pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik publik”

2.1. Rekomandim: Komuna Bradashesh të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit deri ato përmbarimorë, për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **370,000 lekë**, ndaj personave përcaktuar në tabelën nr. 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.05.2015

3. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Kontraktor Komuna Bradashesh ka kryer pagesa të tepërta në vlerën **1,654,660 lekë**, ndaj operatorit ekonomik “S..... “ sh.p.k., në situacionimin e volumeve të punimeve për 4 zëra punimesh të pa kryera në objektin “*Sistemim dhe asfaltim i rrugës nga hotel “Europa” deri në lagjen Harvalet dhe nga ish NMT deri në ish Uzinën nr. 12*”, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 333, datë 17.09.2012.

3.1.Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Komuna Bradashesh, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **1,654,660 lekë**, nga operatori ekonomik “S...” sh.p.k., paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “*Sistemim dhe asfaltim i rrugës nga hotel “Europa” deri në lagjen Harvalet dhe nga ish NMT deri në ish Uzinën nr. 12*”.

Brenda datës 30.05. 2015

4. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Kontraktor Komuna Bradashesh ka kryer pagesa të tepërta në vlerën **447,070 lekë**, për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në 4 zëra punimesh, në objektin “*Sistemim dhe asfaltim i rrugëve të brendshme në fshatin Kusarth (lagja e Qevanëve) Balëz*”, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 225, datë 02.05.2011.

4.1. Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Komuna Bradashesh të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **447,070 lekë**, nga operatori ekonomik “*Sh.a. Rruga nr. 2*“ sh.p.k., paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera për 4 zëra punimi, në objektin “*Sistemim dhe asfaltim i rrugëve të brendshme në fshatin Kusarth (lagja e Qevanëve) Balëz*”.

Brenda datës 30.05. 2015

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 dhe 154 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, të ndryshuar dhe të “Kontratës individuale të punës”, i kemi kërkaur Kryetarit të Komunës Bradashesh, duke i lënë në kompetencë, që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, të përcaktojë masat sipas shkallës së përgjegjësisë dhe të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore ndaj 8 punonjësve si më poshtë:

1. z.G.K me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës dhe në cilësinë e kryetarit të komisionit për “blerjet me vlera të vogla” për periudhën viti 2013, viti 2014, në cilësinë e kryetarit të KVO në tenderin me objekt *“Ndërtimi i Shkollës së Mesme Katund i Ri”* dhe në tenderin me objekt *“Blerje pjesë këmbimi dhe montim çmontim për nevojat e komunës”*, sa trajtuar më poshtë:

- Për të meta dhe mangësi për hartimin e zbatimin e buxhetit të komunës, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2000 “Për Menaxhimin e Sistemit të Buxhetit në Republikën e Shqipërisë”. - Për pagesa të kryera për karta telefoni celular për vitin 2012 dhe vitin 2013 për punonjësit e komunës, në kundërshtim me pikën 9,14 dhe 15 të VKM nr. 864 datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik publik”.

-Për të meta dhe mangësi në zbatimin e procedurave për prokurimet “blerje më vlerë të vogël”, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2001 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Udhëzimin e APP nr. 2 datë 28.3.2013 “Për prokurimet blerje me vlera të vogla”, i ndryshuar.

- Për të meta dhe mangësi në zbatimin e procedurave për tenderin e zhvilluar me datë 03.07.2014, me objekt *“Ndërtimi i Shkollës së Mesme Katund i Ri”*, ku është shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomik “Ergi” & “Bajrami N”, nga ku rezulton se operatori ekonomik “Bajrami N”, ka patur detyrime të pashlyera ndaj komunës para zhvillimit të tenderit, në kundërshtim me kriteret e dokumenteve standarde të tenderit, germa “a”, “b”, pika 2, të VKM nr. 1 datë 08.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

- Për të meta dhe mangësi në zbatimin e procedurave për tenderin me objekt *“Blerje pjesë këmbimi dhe montim çmontim për nevojat e komunës”*, të zhvilluar me datë 18.03.2014, ku është shpallur fitues operatori ekonomik “R& R Grup” sh.p.k. me vlerë të ofertës 3.648.900 lekë, nga ku rezulton se në preventivin e tenderuar nuk janë përcaktuar saktë zërat e punës, pasi mungojnë zërat e punës për montim dhe çmontim të pjesëve të këmbimit, në kundërshtim me pikën 2, neni 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2001 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, germën “c”, pika 2, kreu II, të VKM nr. 1 datë 08.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

2. znj.K.A, me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Administratës, në cilësinë e anëtarit të komisionit për “blerjet me vlera të vogla” për periudhën korrik 2012 deri me 31.12.2012 dhe në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderin me objekt *“Ndërtimi i Shkollës së Mesme Katund i Ri”* dhe në tenderin me objekt *“Blerje pjesë këmbimi dhe montim çmontim për nevojat e komunës”*, sa trajtuar më poshtë:

-Për të meta dhe mangësi në zbatimin e procedurave për prokurimet “blerje më vlerë të vogël”, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2001 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Udhëzimin e APP nr. 2 datë 28.3.2013 “Për Prokurimet Blerje me Vlera të Vogla”, i ndryshuar.

- Për të meta dhe mangësi në zbatimin e procedurave për tenderin me objekt *“Ndërtimi i Shkollës së Mesme Katund i Ri”*, ku është shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomik “Ergi” sh.p.k. & “Bajrami N” sh.p.k., nga ku rezulton se operatori ekonomik “Bajrami N”, ka patur detyrime të pashlyera ndaj komunës para zhvillimit të tenderit, në kundërshtim me kriteret e dokumenteve standarde të tenderit, germa “a”, “b”, pika 2, të VKM nr. 1 datë 08.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

- Për të meta dhe mangësi në zbatimin e procedurave për tenderin me objekt *“Blerje pjesë këmbimi dhe montim çmontim për nevojat e komunës”*, të zhvilluar me datë 18.03.2014, ku është shpallur fitues operatori ekonomik “R& R Grup” sh.p.k. me vlerë të ofertës 3.648.900 lekë, nga ku rezulton se në preventivin e tenderuar nuk janë përcaktuar saktë zërat e punës, pasi mungojnë zërat e punës për montim dhe çmontim të pjesëve të këmbimit, të cilat gjatë zbatimit të kontratës i ka pasqyruar në situacion kontraktori, në kundërshtim me pikën 2, neni 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2001 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me germën “c”,

pika 2, kreu II, të VKM nr. 1 datë 08.01.2007”Për Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

3. znj.Dh.B, me detyrë Inspektore e Ndihmës Ekonomike, në cilësinë e anëtarit të komisionit për “blerjet me vlera të vogla” për periudhën viti 2012, dhe aktualisht mban të njëjtën detyrë.

4. znj.O.K, me detyrë Inspektore e Marrëdhënieve me Jashtë, në cilësinë e anëtarit të komisionit për “blerjet me vlera të vogla” për periudhën viti 2013, dhe aktualisht mban të njëjtën detyrë.

5. z.V.Ç, me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Tatim Taksave, në cilësinë e anëtarit të komisionit për “blerjet me vlera të vogla” për periudhën viti 2013, dhe aktualisht mban të njëjtën detyrë.

Për të tre këta punonjës u konstatuan të meta dhe mangësi sa trajtuar më poshtë:

-Për të meta dhe mangësi në zbatimin e procedurave për prokurimet “blerje me vlerë të vogël”, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2001 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Udhëzimin e APP nr. 2 datë 28.3.2013 “Për prokurimet blerje me vlera të vogla”, i ndryshuar.

6. Lavdie Çollaku, me detyrë Sekretare e Këshillit të Komunës, në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderin me objekt “*Ndërtimi i Shkollës së Mesme Katund i Ri*” dhe në tenderin me objekt “*Blerje pjesë këmbimi dhe montim çmontim për nevojat e komunës*”, aktualisht mban të njëjtën detyrë, *sa trajtuar më poshtë:*

- Për të meta dhe mangësi në zbatimin e procedurave për tenderin me objekt “*Ndërtimi i Shkollës së Mesme Katund i Ri*”, ku është shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomik “Ergi” sh.p.k. & “Bajrami N” sh.p.k. , nga ku rezulton se operatori ekonomik “Bajrami N”, ka patur detyrime të pashlyera ndaj komunës para zhvillimit të tenderit, në kundërshtim me kriteret e dokumenteve standarde të tenderit, germa “a”, “b”, pika 2, të VKM nr. 1 datë 08.01.2007”Për Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

- Për të meta dhe mangësi në zbatimin e procedurave për tenderin me objekt “*Blerje pjesë këmbimi dhe montim çmontim për nevojat e komunës*”, të zhvilluar me datë 18.03.2014, ku është shpallur fitues operatori ekonomik “R& R Grup” sh.p.k. me vlerë të ofertës 3.648.900 lekë, nga ku rezulton se në preventivin e tenderuar nuk janë përcaktuar saktë zërat e punës, pasi mungojnë zërat e punës për montim dhe çmontim të pjesëve të këmbimit, të cilat gjatë zbatimit të kontratës i ka pasqyruar në situacion kontraktori, në kundërshtim me pikën 2, neni 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2001 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, germën “c”, pika 2, kreu II, të VKM nr. 1 datë 08.01.2007”Për Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

7. z.Y.A me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Kontroll Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për periudhën 01.07.2012 deri 31.12.2014, detyrë që e mban aktualisht, *sa trajtuar më poshtë:*

- Për të meta e mangësi, pasi nuk ka regjistruar të dhënat e përgjithshme e individuale, sipas mjeteve tradicionale të informimit dhe në regjistrin e planifikimit të territorit, për territorin e tyre administrative, ku të zhvillojë e të nxisë veprimtarinë profesionale në fushën e planifikimit të territorit, në kundërshtim me neni 13, ligji nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, ligjin 110/2013.

- Për të meta e mangësi në plotësimin me dokumentacionin përkatës, të dosjeve që plotësohen sipas kërkesave për leje zhvillimore, në kundërshtim me neni 13, ligji nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, ligjin 110/2013.

8. z.A.Xh me detyrë Përgjegjës i Policisë së Komunës për periudhën 01.07.2012 deri 31.12.2014, detyrë që e mban aktualisht, *për të meta dhe mangësi sa trajtuar më poshtë:*

- Nuk ka zbatuar me përgjegjësi detyrat, pasi gjatë ushtrimit të detyrës, punonjësit e policisë së komunës nuk kanë vepruar duke aplikuar masa administrative “dënim me gjobë”, për rastet kur janë konstatuar kundërvajtje administrative, në kundërshtim me kërkesat e nenit 13, të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe të Komunës”.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenin 5/b të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014 dhe nenin 15 "Sanksionet", të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, i kemi kërkuar **Kryetarit të Komunës Bradashesh ti propozojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore të Qarkut Elbasan**, që ka në juridiksion territorin ku ndodhen objektet e trajtuara sipas kontratave (duke i bashkëlidhur fotokopjen e procesverbalit përkatës që trajton çështjen), që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur sanksionet si më poshtë:

Dënimin me gjobë, për dy subjektet mbikëqyrës të punimeve të ndërtimit, respektivisht:

1. Për Subjektin "E...K...sh.p.k., përfaqësuar nga **z. K.M.**, **mbikëqyrës i punimeve**, me licencë nr. MK 1667/1, me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit nr. 340, datë 17.09.2012, për periudhën 17.09.2012 deri 17.08.2013, në vlerën 480,000 lekë, për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për objektin **"Sistemim dhe asfaltim i rrugës nga hotel "Europa" deri në lagjen Harvales dhe nga ish NMT deri në ish Uzinën nr. 12"**, Komuna Bradashesh, për shkak se:

a-Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyrojnë me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i situacionimit të katër zëra punimesh, me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën 1,654,660 lekë pa TVSh, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik "S..." sh.p.k.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit", të ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në procesverbalin nr. 6 dhe në faqen 50-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Për Z. Dh.D., **mbikëqyrës i punimeve**, me licencë nr. MK 1890, me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit 200/2, datë 02.05.2011, për periudhën 02.05.2011 deri 0.11.2014, në vlerën 210,505 lekë, për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për objektin **"Sistemim dhe asfaltim i rrugëve të brendshme në fshatin Kusarh (lagja e Qevanëve) Balëz"**, Komuna Bradashesh, për shkak se:

a-Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyrojnë me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i situacionimit të katër zëra punimesh, me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën 447,070 lekë pa TVSh, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik "Sh.a. ..." sh.p.k.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit", të ndryshuar.

Nga komuna Bradashesh, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezultojnë se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Luan Kuka, Din Zeneli, Pal daçi dhe Dorino Meçe, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT